

## PO PLAÇKITEN TE ARDHURAT E ARSIMITAREVE SHQIPTARË

Arësimitarët shqiptarë në Kosovë janë duke u ballafaquar me kapërthyer në qaste të vështira të veprimit dhe të egzistimit. Përveq tjerash po përjetojnë edhe qastët kur në pikë të ditës, pa kurfar maske para syve të tërë botës, arësimitarët serbë e malazezë po ua plaqkisin mjetët materiale - të ardhurat personale e këtë plaqke e shikojnë si "normale" në kushtet në të cilat punojnë dhe jetojnë.

Plaçkitja përkrahet nga pushteti okupues serb dhe ka marrë formën zyrtare me vendimet e "Pleqsisë" se një far Fondit krahinor të arsimit fillor dhe të mesëm, me të cilat vendime qysh prej 1 janarit 1991, është ndërprerë finansasimi i mësimit dhe i arsimtarëve shqiptar të klasëve të para dhe pesta të shkollës fillore, i mësimit dhe i arsimtarëve shqiptarë të klasëve të para të shkollave të mesme, për drejtor, pedagog, ndihms drejtor dhe sekretar shqiptar.

Mjetët e caktuara edhe për arsimtarët shqiptarë, në bazë të regjistrave të të ardhurave personale të shkollave vërtetohet se i kanë marrë arsimtarët serbë e malazezë. Në regjistrat për të ardhurat personale mungojnë të ardhurat e kategorive të arsimtarëve të përmendura në vendimet e Fondit e rrogat e arsimtarëve tjerë shqiptar të shkollave fillore (kë të klasës II-IV dhe VI-VIII) u lejuan në shumën prej 2.500- 3.224 dinarë, kurse për arsimtarët serbë e malazezë starti i rrogës ishte 4.532 dinarë. Deri sa në regjistrat e shkollave të mesme mungojnë rrogat e të gjithë arsimtarëve shqiptar, kurse arsimtarët serbë e malazezë startin e të ardhurave e kishin rreth 7.500 dinarë. Sipas kriterëve për ndarjen e të ardhurave personale për arsim, akontacioni i të ardhurave për muajt e parë të këtij viti duhet të ishte mesatarja e të ardhurave për muajt dhjetor të vitit të kaluar e që në Kosovë ka qenë 3.224 dinarë. Rrogat që i kanë marrë mbi këtë mesatare arsimtarët serbë e malazezë, ishin të dedikuara për arsimtarët shqiptar, do të thotë se janë mjetët e arsimtarëve shqiptar për të cilët Fondi ka ndërprerë finansimin, janë paratë e plaçkitura të arsimtarëve shqiptarë.

Me një veprim të tillë është bërë diskriminim, është fyer njiteti njerëzor e nacional, janë cenuar dispoziata pozitive kushtetuese ligjore të cilat rregullojnë lëmin e arsimit, të marrëdhënies së punës të të ardhurave. Po ashtu në të njejtën kohë janë cenuar edhe konventat kobëtare të cilat ika ratifikuar Jugosllavia si dhe Deklarata e përshme mbi të drejtat e njeriut. Kjo nuk duhet të çohet na çuditë,

kur dihet se Sërbia për politikë zyrtare e ka diskriminimin, apartei-  
din dhe racizmin.

Megjithse, në kushtet e një kaosi që dominon momentalisht  
në jurispodencën e Kosovës, çdo kontestim i veprimit të ndonjë organi  
legjitim e jolegjitim është absurd, por pa marrë parasysh në këtë  
absurditet është akt civilizues që padrejtësitë të kontestohen, pran-  
daj është errugës që çdo shkollë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese  
e Kosovës të vlesojë kushtetushmerinë dhe ligjshmërinë e formimit dhe  
të veprimit të këtyre far fonedeve, kur dihet se asnjë Fond gjerë me  
tash nuk është themeluar dhe nuk vepron në harmoni me dispozitat kusht-  
etuese dhe ligjore. Po ashtu, arsimtarët shqiptarë dhe drejtorët e  
shkollave duhet të kontestojnë edhe mënyrën e tashme të ndërrjes së  
të ardhurave personale nepërmas të Fleqsisë së shkollës ose të ndonjë  
organi tjetër që "kryen" funksionin e saj si edhe nepërmas të Gjyka-  
tës themelore të punës së bashkuar.

Po shihet se perspektiva e shkollës shqipe në përgjithësi  
si edhe e vetë shqiptarëve në kushte të këtij okupimi është shumë e  
zymtë. Por, dihet se çdo gjë e ka fundin e vet, prandaj edhe duhet të  
shpresojmë se kjo gjendje së shpejti do të përfundojë.

Ziadin Gashi

